

Analizë e shkurtër  
**Ligjet nuk po e mbrojnë Oendrën Historike**  
Prill 2014, Prizren

## PËRMBAJTJA

I. Hyrje .....	2
II. Qendra Historike e Prizrenit .....	2
III. Inventari shtetëror i trashëgimisë kulturore .....	3
IV. Konservimi i integruar i trashëgimisë kulturore .....	4
V. Planifikimi hapësinor dhe trashëgimia kulturore .....	5
VI. Ndërtimi dhe legalizimi .....	7
VII. Veprimtaria inspektuese për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore .....	7
VIII. Dëmtimi i trashëgimisë kulturore dhe sanksionet .....	8
IX. Përfundim .....	8
EC Ma Ndryshe .....	9

*Kjo analizë e shkurtër është përpiluar në kuadër të projektit "Urbanism Watch",  
i përkrahur nga Fondacioni i Kosovës për shoqëri të Hapur - KFOS*

**SOROS**

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

## Hyrje

Shteti i Kosovës ka kornizë legislative dhe institucionale shumë të favorshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Një numër ligjesh, aktesh nënligjore, dokumentesh strategjike të nivelit qendror janë në fuqi tashmë një kohë të gjatë. Realizimi i obligimeve ligjore që dalin nga këto dokumente është përgjegjësi e një numri të madh institucioneve qendrore dhe lokale, përfshi ministritë e linjës, komunat, gjyqësorin dhe policinë. Këto përgjegjësi janë tëpërfshirë në mënyrë shumë të qartë dhe nuk lënë aspak hapësirë për interpretime ose keqkuptime. Në rastin e Qendrës Historike të Prizrenit, përveç legjislacionit bazik (trashëgimia kulturore dhe planifikimi hapësinor) janë miratuar edhe ligjet për zonat e veçanta të mbrojtura dhe ai për Qendrën Historike të Prizrenit. Në të njëjtën kohë, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka të miratuar edhe master planin për konservimin dhe zhvillimin e kësaj zone.<sup>1</sup>

Me gjithë këtë kornizë legislative dhe institucionale mjaft të avansuar, Qendra Historike e Prizrenit vazhdon të degradohet në mënyrë sistematike. Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2013 i publikuar nga Komisioni Evropian ka konfirmuar shqetësimet e shoqërisë civile në Prizren dhe Kosovë për degradimin e trashëgimisë kulturore. Raporti në mënyrë eksplicite konstaton se “interesat biznesore shpesh herë mbizotërojnë kundruall interesave të trashëgimisë kulturore”, duke aluduar në ndërtimet pa leje. Njëherësh, Komisioni Evropian, në pjesën e raportit që flet për të drejtat kulturore ka bërë thirrje për “veprime të fuqishme për të ndaluar aktivitetet ilegale dhe degraduese si dhe korrigjimin e atyre ndërtimeve që kanë tejkalime”.<sup>2</sup> Ky

<sup>1</sup> Komuna e Prizrenit, Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, në <http://kk.rks-gov.net/prizren/City-guide/Plani-i-konzervimit.aspx>

<sup>2</sup> Komisioni Evropian, Raporti i Progresit 2013 për Kosovën, në

degradim është tregues i dështimit institucional për të mbrojtur Qendrën Historike të Prizrenit dhe konfirmim i konstatimit se ligjet janë të pamjaftueshme për të siguruar rend urbanistik dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore në këtë qendër.

Qytetet e vjetra të Prishtinës, Prizrenit dhe Gjakovës janë ndër më të prekurat nga ndërtimi i pakontrolluar, ndërsa këtij fati nuk i kanë shpëtuar as qytetet e tjera të Kosovës. Institucionet e shtetit, në të dyja nivelet e qeverisjes, as sot nuk e kanë krijuar sistemin e koordinimit mes dy sferave të politikave publike, planifikimit hapësinor (dhe urban) dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Me një fjalë, planifikimi hapësinor dhe urban vazhdon të mbetet një sferë e izoluar e hartimit dhe zbatimit të politikave, duke e neglizhuar në tërësi nevojën për të marrë në konsideratë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.<sup>3</sup> Në nivelin qendror, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i kanë hartuar dhe miratuar të gjitha ligjet dhe politikat e rëndësishme pa e involvuar njëra tjetrën.<sup>4</sup>

Kjo analizë përmbledh në një vend tërë kornizën legislative të Kosovës për mbrojtje të trashëgimisë kulturore, me referencë të veçantë ndaj Qendrës Historike të Prizrenit. Kjo është edhe një përpjekje e EC Ma Ndryshe për t’iu kujtuar institucioneve përgjegjësitë e tyre dhe kërkuar veprim në parandalimin e degradimit të mëtejshëm të Qendrës Historike.

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/brochures/kosovo\\_2013.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf)

<sup>3</sup> EC Ma Ndryshe, Gabim pas gabimi, në

[http://ecmandryshe.org/repository/docs/Gabim\\_pas\\_gabimi\\_ALB.pdf](http://ecmandryshe.org/repository/docs/Gabim_pas_gabimi_ALB.pdf)

<sup>4</sup> Në mesin e këtyre ligjeve dhe politikave bëjnë pjesë Ligji për Trashëgiminë Kulturore, Politika e Konservimit të Integruar të Trashëgimisë Kulturore, Ligji për Planifikimin Hapësinor, Plani Hapësinor i Kosovës

### Qendra Historike e Prizrenit

Qendra Historike mbrohet me një ligj të veçante, qëllimi i të cilit është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.<sup>5</sup>

Ligji kërkon nga Komuna e Prizrenit, që në konsultim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit të hartojë, miratojë dhe zbatojë dokumentet e planifikimit hapësinor dhe urbanistik që kanë të bëjnë me Qendrën Historike të Prizrenit në pajtim me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Ligjin për Trashëgiminë kulturore.

Ligji përcakton aktivitetet e kufizuara dhe të ndaluara në territorin e Qendrës Historike.

Aktivitetet e kufizuara përfshijnë:

- Bashkimin e dy apo më shumë parcelave kadastrale në një njësi të vetme,
- vendosjen e kiosqeve, tezgave, tavolinave dhe elementeve tjera montazhe, parkingjeve ose të ngjashme që do të pengonte vizurat dhe qasje të lirshme në monument,
- muzikën me zë më të lartë se (shtatëdhjetë) 70 db, përveç gjatë ngjarjeve/organizimeve të natyrës publike, për të cilat merret paraprakisht leja prej Komunës,
- vendosjen e reklamave të përhershme, shenjave private, dekorimeve apo elementeve penguese me sipërfaqe më të madhe se një metër katror (1m<sup>2</sup>) dhe pa pëlqimin e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit.

Ndërsa, aktivitetet e ndaluara përfshijnë:

- aktivitetet ndërtimore apo transformuese që rezultojnë me ngritjen e një objekti të

vetëm në dy apo më shumë parcela kadastrale,

- aktivitetet ndërtimore apo transformuese që do të rezultonin në objekte me lartësi më të madhe se Përdhese + dy (2) etazhe (P+2),
- aktivitetet ndërtimore apo transformuese që do të rezultonin me objekte ku sipërfaqja e përdheseve tejkalon 150m<sup>2</sup>,
- aktivitetet që do të rezultonin në ndryshimin permanent të morfologjisë natyrore të terrenit,
- pompat e reja të derivateve të naftës si dhe ndërtimet industriale, fabrikat ose zhvillimet e ngjashme përfshirë eksploatimin e burimeve minerale dhe furrënaltat,
- aktivitetet e natyrës komerciale të cilat përfshijnë një sipërfaqe të hapësirës së brendshme më të madhe se 150m<sup>2</sup> duke përfshirë depot, punëtoritë mekanike, supermarketet dhe klubet e natës,
- funksionimi i kazinove, bastoreve dhe veprimtarive tjera të lojërave të fatit.

Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit i ka paraprirë Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, që precizonte se Zona e Veçantë e Mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit do të themelohet nga organet komunale të Prizrenit në bashkëpunim me KZM dhe do të përfshijë objektet e Kishës Ortodokse, objektet otomane, katolike, laike dhe objektet e tjera të rëndësisë së veçantë historike dhe kulturore.<sup>6</sup>

Në anën tjetër, Kuvendi i Komunës së Prizrenit në vitin 2008 pati miratuar Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit. Ky dokument përcakton parametrat e mbrojtjes dhe zhvillimit të qendrës historike, si dhe përfshin analiza të zonës lidhur me transportin në zonën e planifikuar, shfrytëzimin e tokës dhe shfrytëzimin e ndërtesave në katin përdhese dhe katin e parë, gjendjen e ndërtesave,

<sup>5</sup> Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, në <http://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2836>

<sup>6</sup> Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, në <http://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2529>

etazhitetin e ndërtesave, materialet ndërtimore, pronat, zotërimin e ndërtesave, përshtatshmërinë e ndërtesave me strukturën fizike të zonës dhe rrethinës së saj.<sup>7</sup>

### Inventari shtetëror i trashëgimisë kulturore

Sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë, identifikimi dhe përcaktimi i potencialit të trashëgimisë kulturore si pronë e mbrojtur bëhen nga autoritetet e trashëgimisë kulturore në bashkëpunim me autoritetet e planifikimit hapësinor. Sipas ecursisë së proceseve të mbrojtjes, pronat e trashëgimisë kulturore identifikohen, regjistrohen, dokumentohen, vlerësohen, propozohen dhe përcaktohen për mbrojtje përmes sistemit të Invenarit Shtetëror. Përcaktimi i pronave të trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohëshme apo të përherëshme bëhet me vlerësime nga autoritetet e trashëgimisë kulturore. Paraqitja e propozimeve për mbrojtje bëhet nga personat fizik dhe juridik, me dokumentacion të mirëfilltë. Pronat e trashëgimisë kulturore të përcaktuara për mbrojtje regjistrohen në Listën e Trashëgimisë Kulturore të Republikës së Kosovës.<sup>8</sup> Për më tepër, në shtator të vitit 2008, MKRS pat miratuar Rregulloren mbi regjistrimin, dokumentimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e trashëgimisë kulturore për mbrojtje, si një përpjekje për të konkretizuar nenet e Ligjit për Trashëgimi Kulturore mbi inventarizimin.<sup>9</sup>

Ligji për Qendrën Historike të Prizren parasheh që kjo zone e mbrojtur, si pronë e trashëgimisë kulturore në mbrojtje përfshihet në listën e trashëgimisë kulturore, në mbrojtje të

përherëshme të Republikës së Kosovës. Realizimi i këtij obligimi ligjor mbetet peng i procesit të bllokuar të intetarit shtetëror të Kosovës.

Përveç ligjit bazë për trashëgiminë kulturore, MKRS ka nxjerrë edhe shtatë akte nënligjore, të cilat mëtojnë të rregullojnë obligimet ligjore të këtij sektori. Aktet nënligjore të miratuara në vitin 2008 përfshijnë këto fusha: gërmimet arkeologjike, qasjen publike në trashëgiminë kulturore në pronësi private, konservimet dhe restaurimet, Inspeksionin, mbrojtjen ligjore, trashëgiminë e luajtshme, licensimin për aktivitet komercial.<sup>10</sup> Përkundër kësaj kornize ligjore, në vitin 2012 MKRS, duke konstatuar moszbatimin efektiv të legjislacionit në trashëgimi kulturore, inicioi rishkrimin e Ligjit për Trashëgimi Kulturore. Sipas ndryshimeve të propozuara, në ligjin e ri parashihen këto masa kryesore: koncesionimi i pronave të trashëgimisë kulturore, Inspektorati i trashëgimisë kulturore dhe funksionalizimi i KGTK.<sup>11</sup>

### Konservimi i integruar i trashëgimisë kulturore

Një nga politikat më thelbësore të trashëgimisë kulturore, e miratuar nga MKRS në shtator të vitit 2010 në formën e dokumentit strategjik është ajo mbi konservimin e integruar.<sup>12</sup> Këtij dokumenti të politikave i kishte paraprirë një Strategji Konservimi për Trashëgiminë Kulturore në Kosovë, e prodhuar në vitin 2005. Kjo strategji pëmbante këto rekomandime: ridefinimi i përgjegjësive institucionale, themelimi i departamentit të trashëgimisë kulturore, kompletimi i kornizës ligjore, koordinimi i donatorëve, inventari i pronave të

<sup>7</sup> Komuna e Prizrenit, Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, në <http://kk.rks-gov.net/prizren/City-guide/Plani-i-konzervimit.aspx>

<sup>8</sup> Këshilli I Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Mbrojtja e Pronave të Trashëgimisë Kulturore në Republikën e Kosovës

<sup>9</sup> Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Rregullore mbi regjistrimin, dokumentimin dhe përzgjedhjen e trashëgimisë kulturore për mbrojtje, në <http://www.mkrs-ks.org/?page=1,15>

<sup>10</sup> Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Legjislacioni, në <http://www.mkrs-ks.org/?page=1,15>

<sup>11</sup> Projektligji i ri për trashëgiminë kulturore, përkundër premtimeve të Ministrisë se do të miratohet në vitin 2013, ende nuk është proceduar në Kuvendin e Kosovës për shqyrtim parlamentar.

<sup>12</sup> Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Dokument Strategjik, Konservimi i integruar i tërësive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Kosovës

trashëgimisë kulturore dhe edukimi. Një tjetër dokument i politikave në këtë sektor është edhe Doracaku mbi menaxhimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë, i prodhuar në vitin 2007 për të përshkruar hapat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në përputhje me standardet ndërkombëtare për formulimin e politikave të menaxhimit. Së fundmi, është prodhuar edhe Udhëzuesi mbi Trashëgiminë Kulturore (mjetet teknike për konservim dhe menaxhim të trashëgimisë), si një pikënisje për vendosjen e standardeve dhe masave të trashëgimisë për të nxitur përfshirjen aktive të autoriteteve shtetërore, profesionistëve dhe komunitetit në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Politika e konservimit të integruar paraqet domosdoshmërinë për koordinim institucional për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Një qasje e tillë presupozon se trashëgimia kulturore është përgjegjësi shumë më e gjerë se sa e një institucioni të vetëm. Konservimi i integruar ka të bëjë me bashkëpunimin ndërsektoral mes organeve të ndryshme publike administrative, si dhe me koordinimin e masave legjislative në mënyrë që të plotësojnë dhe zgjerojnë njëra tjetrën.<sup>13</sup> Konkretisht, struktura institucionale e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në Kosovë, përtej kompetencave të MKRS, përfshin edhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe qeveritë lokale. Në këtë pikë, mund të shihet më së miri paaftësia e institucioneve të Kosovës për të krijuar një strukturë shtetërore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në të njëjtën kohë, kjo situatë është dëshmi dhe pasojë direkte e mungesës së një Plani Kombëtar në këtë sektor. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, organ ligjor për mbështetjen e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ka përgatitur udhëzuesin për Politikën

Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore (2011). Përgatitja e kësaj politike shumësektoriale është në varshmëri të mbështetjes së specializuar profesionale, dhe ka koston e vet financiare, i cili fond ende nuk është siguruar.

### Planifikimi hapësinor dhe trashëgimia kulturore

Ligji për Planifikimin Hapësinor në parimet themelore të tij përcakton se planifikimi hapësinor dhe rregullimi, përveç tjerash duhet të bazohen edhe në promovimin e interesave të përbashkëta të qytetarëve të Kosovës, duke mbrojtur burimet natyrore, trashëgiminë kulturore dhe përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm.<sup>14</sup>

Sipas këtij ligji, në Kosovë ekzistojnë dy nivele të planifikimit hapësinor:

- planifikimi i nivelit qendror për tërë territorin e Kosovës përmes dokumenteve të planifikimit hapësinor (Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës dhe Planet Hapësinore për Zona të Veçanta) dhe
- planifikimi i nivelit lokal për tërë territorin e komunave përmes dokumenteve të planifikimit hapësinor (Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme).

Subjektet përgjegjëse që ushtrojnë funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë përkatëse, që bazohen në legjislacionin në fuqi për çështje të planifikimit hapësinor janë:

- në nivel qendror – Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- në nivel lokal – Kuvendi Komunal dhe autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Kuvendi i Kosovës është përgjegjës për aprovimin përfundimtar të:

<sup>13</sup> Baza e parimeve të konservimit të integruar për herë të parë u vendos në Kartën Evropiane të Trashëgimisë Arkitekturale dhe Deklaratën e Amsterdimit, miratuar në vitin 1975 nga Komisioni i Ministrave i Këshillit të Evropës

<sup>14</sup> Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Planifikimin Hapësinor, në <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865>

- propozim vendimeve për hartimin e Planit Hapësinor të Kosovës dhe të Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta pasi të aprovohen nga Qeveria e Kosovës,
- Planin Hapësinor të Kosovës, pasi të aprovohet nga Qeveria e Kosovës,
- Hartës Zonale të Kosovës pasi të aprovohet nga Qeveria e Kosovës,
- Planet Hapësinore për Zona të Veçanta pasi të aprovohen nga Qeveria e Kosovës.

Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për:

- shqyrtimin dhe aprovimin e Planit Hapësinor të Kosovës para se të dorëzohet për aprovim në Kuvend të Kosovës,
- shqyrtimin dhe aprovimin e Hartës Zonale të Kosovës,
- shqyrtimin dhe aprovimin e Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta, para se të dorëzohen për aprovim në Kuvend të Kosovës,
- shqyrtimin dhe aprovimin e revidimit të Hartës Zonale të Kosovës,
- shqyrtimin dhe aprovimin e revidimit të Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor në pajtim me dispozitat e këtij ligji, përveç tjerash është përgjegjëse edhe për:

- përgatitjen e politikave për fushëveprimin e planifikimit hapësinor,
- hartimin dhe koordinimin e kornizës ligjore të planifikimit hapësinor,
- përgatitjen e propozim-vendimeve për hartimin e Planit Hapësinor të Kosovës dhe Hartës Zonale të Kosovës dhe Planet Hapësinore për Zonat e Veçanta, si dhe për revidimin e tyre,
- bashkërendimin e objektivave të autoriteteve qendrore në planifikim hapësinor dhe territorial, në Planin Hapësinor të Kosovës, Hartën Zonale të Kosovës dhe Planet Hapësinore për Zona të Veçanta,
- të inkurajuar dhe siguruar që pjesëmarrja e publikut është përfshirë në procesin e hartimit dhe të zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor,

- përcaktimin e kushteve ndërtimore dhe dhënien e lejes së ndërtimit për ndërtime brenda sipërfaqes së mbrojtur, dhe
- bashkërendimin me komunat, organizatat lokale dhe ndërkombëtare me qëllim të harmonizimit të planifikimit hapësinor në Kosovë me normat e BE-së dhe ndërkombëtare.

Kuvendet e Komunave janë përgjegjës për:

- aprovimin e propozim vendimit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, Hartën Zonale të Komunës, si dhe të Planeve Rregulluese të Hollësishme,
- aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës, pasi të aprovohet nga Drejtoritë sektoriale të Komunës në dy fazat vijuese të hartimit,
- aprovimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, pasi të aprovohen nga Drejtoritë sektoriale të Komunës.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor përveç tjerash është përgjegjës edhe për:

- zhvillimin hapësinor, përmes hartimit dhe zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të deklaruara në dokumentet e planifikimit hapësinor,
- hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor në përputhje të plotë me Planin Hapësinor të Kosovës, Hartën Zonale të Kosovës dhe me normat teknike të planifikimit hapësinor,
- përgatitjen e propozim-vendimeve për hartimin e Planit Hapësinor të Komunës dhe Hartës Zonale të Komunës dhe Planet Hapësinore për Zonat e Veçanta, si dhe për revidimin e tyre.
- koordinimin me Drejtoritë sektoriale dhe burimeve njerëzore brenda komunës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal për çdo tetë (8) vite,
- hartimin e Hartës Zonale të Komunës, në përputhje me Hartën Zonale të Kosovës dhe normat teknike të planifikimit hapësinor, nëntë (9) muaj pas miratimit përfundimtar të Planit Zhvillimor Komunal,

- hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, në përputhje me Hartën Zonale të Komunës, normat teknike të planifikimit hapësinor, dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura,
- informimin vjetor në Ministri për gjendjen e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale dhe Planet Rregulluese të Hollësishme dhe gjendjen e zbatimit të tyre,
- njoftimit publik dhe shqyrtimit publik para se të finalizohet Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Kosovës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme.

Ligji për Planifikimin Hapësinor përcakton edhe kufizimet brenda sipërfaqeve të mbrojtura, të cilat përcaktojnë mbrojtjen dhe ruajtjen afatgjate të një hapësire gjeografike me karakteristika të veçanta të burimeve natyrore, të florës dhe faunës, dhe të trashëgimisë kulturore arkitekturale, arkeologjike dhe peizazheve kulturore, me potencial për zhvillim social dhe ekonomik për vendin.

Sipas këtij ligji, në sipërfaqe të mbrojtur nuk lejohet:

- ndërtimi i rrugëve magjistrale dhe regionale,
- ndërtimi i godinave më të larta dhe atyre që nuk janë në harmoni me ndërtesat ekzistuese fqinje,
- zhvillimi i veprimtarisë së industrisë së rëndë,
- instalimi mbitokësor i furnizimit të rrymës elektrike, telekomunikacionit, përçuesve digjital, etj
- veprimtaritë dhe ndërtimet që ndikojnë në shpyllëzim, tjetërsim apo ndotje të mjedisit,
- planifikimi hapësinor urban dhe rural nga niveli lokal.

### Ndërtimi dhe legalizimi

Ligji për ndërtim, në parimet themelore të tij përcakton se lëshimi i lejes ndërtimore dhe përcaktimi i kërkesave të saj do të zbatohen në pajtueshmëri me, përveç tjerash, edhe parimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë

kulturore. Në pikën e parë të procedurave për lëshimin e lejes ndërtimore, ligji përcakton që leja ndërtimore lëshohet nëse dokumentacioni ndërtimor përgatitet në pajtueshmëri me kushtet ndërtimore dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Kodit si dhe Ligjit mbi mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe zonat e veçanta të mbrojtura.<sup>15</sup> Në anën tjetër, Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje ka përcaktuar se ky ligj nuk vlen për parqet nacionale dhe zonat e mbrojtura. Në nenin e inspektimit të ndërtimeve të përfunduara, ligji parasheh që inspektimet e ndërtimit pa leje duhet të përcaktojnë që aplikimet për leje për legalizim do të refuzohen, pas inspektimit, nëse organi kompetent gjen se ai është i ndërtuar në zonat e mbrojtura dhe zonat e veçanta të trashëgimisë kulturore.<sup>16</sup>

### Veprimtaria inspektuese për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

Ligji për Trashëgiminë Kulturore parasheh edhe punë inspektuese nga inspektorët e caktuar nga MKRS, ndërsa kjo veprimtari parashihet të rregullohet me një akt nënligjor. Inspektorët, sipas ligjit kanë të drejtë të vlerësojnë kushtet dhe gjendjen e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe ndërmarrin masat e duhura për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.<sup>17</sup> Deri tani nuk është miratuar asnjë akt nënligjor për punën e inspektorëve të trashëgimisë kulturore, ndërsa specifikimi i veprimtarisë së tyre pritet të bëhet me ligjin e ri (ende të pamiruar) për trashëgiminë kulturore.

<sup>15</sup> Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Ndërtimin, në <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2567>

<sup>16</sup> Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, në <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8990>

<sup>17</sup> Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Trashëgiminë Kulturore, në <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2533>

Sipas draftit ende të pamiratur të ligjit të ri për trashëgiminë kulturore, Inspektorati do të ketë këto detyra dhe përgjegjesi:

- Inspekton zbatimin e legjislacionit të trashëgimisë kulturore nga të gjithë personat fizikë dhe juridikë në tere territorin e Republikës së Kosovës,
- Inspekton punët në pronat e trashëgimisë kulturore në Listë dhe Regjistër,
- Ka të drejtë të kete qasje në të gjitha pronat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore,
- Urdhëron ndërprerjen e menjëhershme të secilit veprim të paautorizuar ndaj trashëgimisë kulturore.

Për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, organi komunal për inspektim në bashkëpunim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit, cakton inspektorë për mbikëqyrjen e aktiviteteve dhe zhvillimeve në Qendrën Historike të Prizrenit.

Ligji për Inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimi hapësinor dhe ndërtimit, përveç tjerash, parasheh edhe funksionin e inspektoratit të planifikimit hapësinor dhe urbanistik dhe atij të ndërtimit. Inspektorati i planifikimit hapësinor dhe urbanistik ushtron mbikëqyrje administrative dhe kontrollë përmes inspektimit urbanistik në zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor. Inspektorati i ndërtimit në anën tjetër ushtron mbikëqyrje inspektive dhe kontrollë përmes inspektimit ndërtimor në zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve që kanë të bëjnë me fushën e ndërtimit. Ligji po ashtu parasheh edhe funksionin e inspektoratit komunal të ndërtimit, i cili ushtron detyrat dhe përgjegjësitë përmes kontrollit dhe mbikëqyrjes inspektive në zbatimin e ligjeve në fushën e ndërtimit dhe planifikimit hapësinor. Inspektorati komunal i ndërtimit ushtron mbikëqyrjen në zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara me kushtet e ndërtimit dhe lejet

ndërtimore të lëshuara nga komunal.<sup>18</sup>

### **Dëmtimi i trashëgimisë kulturore dhe sanksionet**

Sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore secili person juridik dhe fizik ka për detyrë që të kujdeset për mbrojtjen e tërësisë së trashëgimisë kulturore nëse ai/ajo është pronar, posedues ose shfrytëzues i kësaj trashëgimie kulturore (neni 4.10). Për më tepër ligji parasheh që cilido person fizik apo juridik që dëmton trashëgiminë kulturore, pavarësisht nga marrëdhëniet e tyre pronësore me të, dënohet ose sanksionohet në bazë të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, Ligjit për kundërvajtje dhe në pajtim me nenin 11 të këtij ligji (neni 4.11). Ndërsa neni i sanksioneve i këtij ligji precizon që mosbindja ndaj dispozitave të këtij ligji në lidhje me autorizimin e veprimtarive do të gjohet nga gjykata kompetente me minimum prej 1.000 (një mijë) Euro dhe maksimum prej 500.000 (pesë qind mijë) Euro për secilin veprim të paautorizuar.<sup>19</sup>

Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit parasheh që personi fizik dhe juridik që bën ndërtimin, rrënimin, ndërhyrjet në infrastrukturë apo çfarëdo aktiviteti tjetër të ndaluar, paguan të gjitha shpenzimet e nevojshme për kthimin e objektit të dëmtuar të trashëgimisë kulturore dhe fetare në gjendjen para shkakimit të dëmit. Sipas këtij ligji gjobat e parapara me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Ligjin për Ndërtim, dyfishohen në rast të shkeljeve brenda Qendrës Historike të Prizrenit, ndërsa zbatohen masat sanksionuese të parapara në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore.<sup>20</sup>

<sup>18</sup> Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimi hapësinor dhe ndërtimit, në <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8910>

<sup>19</sup> Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Trashëgiminë Kulturore, në <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2533>

<sup>20</sup> Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, në <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2836>



Edhe Kodi Penal i Kosovës është mjaft i qartë në raport me dëmtimin, shkatërrimin dhe nxjerrjen e paautorizuar të monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës. Sipas Kodit Penal kushdo që dëmton ose shkatërron monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet. Për më tepër, nëse monumenti i mbrojtur ka vlerë të posaçme ose nëse vepra penale rezulton me dëm të rëndë, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. Kodi Penal përcakton edhe dënimet për shkeljet e shkaktuara gjatë restaurimit ose hulumtimit në prona të trashëgimisë kulturore. Sipas Kodit, kushdo që pa autorizimin e organit kompetent kryen punë të konservimit, restaurimit apo punime hulumtuese në ndonjë monument kulturor, ose përkundër ndalimit ose joautorizimit, kryen gërmime apo hulumtime arkeologjike dhe me këtë e shkatërron ose e dëmton rëndë monumentin kulturor apo karakteristikat e tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet. Nëse këto vepra penale kryhen ndaj monumentit kulturor me vlerë apo me rëndësi të posaçme ose rezulton me dëm të madh, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tri (3) vjet.<sup>21</sup>

### Përfundim

Me gjithë këtë kornizë ligjore dhe sistem institucional, Qendra Historike e Prizrenit po degradohet në vazhdimësi. Institucionet e shtetit kanë dështuar në zbatimin e ligjeve, e mbi të gjitha në ndëshkimin e keqbërësve. Dëmtimi dhe shkatërrimi i trashëgimisë kulturore, për shkak të praktikës së mosndëshkimit, po konsiderohet si shkelje e vogël (në rastin më të mirë). Mosndëshkimi po inkurajon veprime tjera degraduese ndaj trashëgimisë kulturore. Ndërtimi i hoteleve

brenda Qendrës Historike në 3-4 vitet e fundit (pothuaj të gjithë me tejkalime) dëshmon më së miri përsëritjen e shkeljeve nëse të parët nuk ndëshkohen. Mosveprimi i institucioneve ka krijuar dhe zhvilluar kulturën e mosndëshkimit në Prizren. Qendra Historike është ndër zonat më të errëta të sundimit të ligjit në Prizren, me mungesë totale të transparencës dhe llogaridhënies.

Siç u argumentua edhe me analizën e kornizës ligjore, mbrojtja dhe zhvillimi i Qendrës Historike të Prizrenit është përgjegjësi e ndarë e dy niveleve të qeverisjes dhe e një numri të madh institucionesh. Për këtë arsye, EC Ma Ndryshe rekomandon koordinim mes institucioneve të shtetit për të vendosur rend urbanistik në këtë zonë. Ky koordinim duhet të zbatohet në disa nivele, përfshi atë brenda komunës së Prizrenit (drejtoritë), komuna në raport me ORTK dhe ministritë përkatëse (kulturë, planifikim hapësinor, qeverisje lokale), institucionet e drejtësisë dhe zbatimit të ligjit dhe mbikëqyrja parlamentare në raport me qeverinë dhe komunën. Paralelisht, ne besojmë në nevojën e organizimit qytetar për të artikulluar presion ndaj institucioneve të shtetit për transparencë dhe llogaridhënie në raport me Qendrën Historike.

Rekomandimi kryesor i kësaj analize është zbatimi i ligjeve përmes ndëshkimit, që do të shërbente si shembull parandalues. Dëmtimi ose shkatërrimi i trashëgimisë kulturore përbën vepër penale dhe mosndëshkimi nënkupton paaftësinë e institucioneve për të siguruar sundim të ligjit. EC Ma Ndryshe beson se vetëm opsioni i ndëshkimit (me gjobë ose burgim) për veprën penale "dëmtim i trashëgimisë kulturore" mund të shpëtojë Qendrën Historike nga shkatërrimi i tërësishëm.

<sup>21</sup> Gazeta Zyrtare e Kosovës, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në <http://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2834>

## EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare “EC Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t’i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014 – 2015), Lidhja mes komunitetit dhe shërbyesve të drejtësisë (2014), Urbanism Watch – Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013 – 2014), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013 – 2014), Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2013 – 2015), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit (2012 - 2013), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Urbanizmi si lexim i qytetit (2014), Qendra Historike e Prizrenit – zonë e (pa)mbrojtur (2014), Qyteti gjithëpërfshirës (2014), Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikimi Urban për Qytetarët (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Prizreni “Qytet i kulturës” - film dokumentar (2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Pesë analiza të projektit “Online Trasparenca”,; 1. Një vit monitorim për më shumë transparencë 2. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 3. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 4. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 5. Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).